

KËRKESË
Nr.5379/5, datë 25.10.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim, me interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit: tokë bujqësore, tokë truall, ndërtim, shtëpi banimi dhe “kulturave bujqësore” që preken nga “Ndërtimi i linjës ajrore të tensionit të lartë të parkut eolik”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k., Tiranë. Me anën e këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e kompensimit përkatës të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për secilin pronar sipas listës emërore të mëposhtme.

Brenda 15 ditëve nga data e fundit e publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës pranë komisionit të posaçëm të shpronësimit.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Nasip Naço